



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1975 Prot

Tiranë, më 13 / 12 / 2019

REKOMANDIM

Nr. 65, datë 13 / 12 / 2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare <http://shendetesia.gov.al/1-programi-i-transparences/>, të Autoritetit Publik "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozite, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;

c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Programi” dhe programi i transparencës shfaqet i ndërlidhur në këtë menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pjesërisht të ndërlidhura me informacionet përkatëse.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv)

informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por, të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

a) një përshkrim të funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të gërmeve a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;

3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.12.2019

KOMISIONERI


Besnik Dervishi



Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – datë 19.11.2019

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <http://shendetesia.gov.al/1-programi-i-transparences/>


Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Programi”, dhe Programi i Transparencës është ndërlidhur në këtë menu.



Nga monitorimi rezulton se, Programi i Transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14, datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu rezulton se kategoritë e informacionit të programit model të transparencës, janë pjesërisht të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse.



7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Informacioni në lidhje me strukturën organizative gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës. Informacioni në lidhje me funksionet dhe detyrat e autoritetit publik është i publikuar në faqen e autoritetit <http://shendetesia.gov.al/misioni-2/> dhe <http://shendetesia.gov.al/organizimi-i-sistemit-shendetesor/> por nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;



Organizimi i sistemit shëndetësor

Sistemi Shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Shitet siguri pjesën më të madhe të shërbimeve që ofronen popullatës si në fushën e promovimit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Sektori privat është akoma në fillimet e para dhe mbulon pjesën më të madhe të shërbimit farmaceutik, shërbimit stomatologjik dhe disa klinika diagnostikuese specializuese të cilat janë përqendruar kryesisht në Tiranë.

Në sektorin publik rolin e identit e luan Ministria e Shëndetësisë e cila është hartuese dhe përzgjedhëse për politikat dhe strategjitë e sistemit shëndetësor, për rregullimin e tij si dhe për koordinimin e të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë shtetit.

Shërbimi shëndetësor diagnostikues dhe kurues është i organizuar në tre nivele: shërbimi parësor, shërbimi spitalor dytësor dhe spitalor terciar.

Shërbimet e shëndetit publik dhe promovimit ofrohen në kuadër të shëndetit parësor dhe mbështetjen dhe mbikqyrjen nga ISHP.

Krahës këtre ofrojnë shërbimet e tyre edhe një sërë institucioneve nacionale si Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Qendra Kombëtare e Mbrojtjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijës, Qendra Stomatologjike Universitare etj.


Në mbështetje të institucioneve shëndetësore funksionojnë edhe Qendra Kombëtare e Imunizimeve, Baza Kombëtare e Qendrës Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe Qendra Kombëtare e Cilësisë Spitalore dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.

Në përjashtim të Tiranës ku në kuadër të një projekti pilot është ngritur shërbimi shëndetësor parësor dhe është krijuar ASHP-ja, në qdo distrikt funksionon një DSHP-Drejtori i Shëndetit Publik e cila duhet të koordinojë të gjitha shërbimet shëndetësore të rejtut. Në 12 rrethet e mëdha (qendra të rajoneve), krahës DSHP-ve funksionojnë si drejtor të veçantë Drejtoria Spitalore dhe Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor. Ky organizim do të rishikohet në përfundim të projektit pilot të ASHP-ve dhe aktualisht krijimi i autoriteteve rajonale që do të koordinojnë funksionimin e shërbimeve shëndetësore në rang rajoni.


Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor


Sigurimi Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë është institucionalizuar në bazë të Ligjit "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" (Nr. 7070) datë 13.10.1994. Ai është i përfshirë në Skemën e Sigurimit Social të Republikës së Shqipërisë.

- "SH 207" - Një tjetër hap strategjik drejt kërkesës së duar
- Organizimi i sistemit shëndetësor
- Disa kështu për një dritë në vlerë
- Informim për Shqipërinë
- 10 Paketat e Para Pa Pagese të Shërbimeve Shëndetësore në Spitalin Publik dhe Jo Publik
- Shqipëria Jo Duhant
- Kanceri i gjendë zvogëlimi i rrezikut është i mundur
- IPA Aduatic
- Koordinim për të drejtën e informimit



7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;





7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlydhur në tabelën e programit të transparencës;

KËRKESË PËR INFORMACION

Emri i Mbledhtit: _____ Adresa postare: _____ Data e kërkesës: ____/____/____
Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____

Forma që kërkon informacionin / dokumentacionin: _____

Vendimi për procedurën e kërkesës: _____


FORMULARI ANKESË

Emri i Mbledhtit: _____ Adresa: _____ Qyteti: _____ Telefon: _____ E-mail: _____


Autoriteti Publik: _____ Adresa: _____ Qyteti: _____


Përkrahësi që vepron të pretenduar si shprehje nga Autoriteti Publik dhe nese disponon dokumente bashkëlydhuar ato: _____

7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;**



7.1.d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni lidhur me përshkrimin e procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik, procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime si dhe struktura e pagave për nëpunësit e tjerë gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës. Mungon informacioni për arsimin, kualifikimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit (CV vetëm e Ministrisë) në faqen e autoritetit [http://shendetesia.gov.al/minister/](http://shendetesia.gov.al/minister/;);**





Struktura_MSHMS_2017.pdf

6/14

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
4.1 DREJTORIA E KONCIPTIMIT DHE TIZBITIT TË TË PROJEKTIVË TË SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALË		1
4.1.1 DREJTORI	1.6	1
4.2 SEKTORI I PËRGATITJES DHE TIZBITIT TË TË PROJEKTIVË PËR SHËNDËTËSINË		1
4.2.1 PËRGATITJES	1.7.1	1
4.2.2 TIZBITI	1.7.2	1
4.3 SEKTORI I PËRGATITJES DHE TIZBITIT TË TË PROJEKTIVË PËR SHËNDËTËSINË SOCIALË		1
4.3.1 PËRGATITJES	1.8.1	1
4.3.2 TIZBITI	1.8.2	1
4.4 DREJTORIA E PËRGJITHSHMË RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR SHËNDËTËSINË DHE MBROJTJEN SOCIALË		11
4.4.1 DREJTORI	1.9	1
4.4.2 DREJTORI I PROGRAMIMIT, STANDARTIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KADRI		

11/11/2019

mbi zbatimin e ligjshmërisë së ministrit në shëndetësi.pdf

1/17



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 229/11 Prot Titane, më 19/09/2016

V E N D I M

Nr. 105, Datë 19/09/2016

P E R
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË MINISTRINË E SHËNDËTËSISË, TIRANË,
"MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË RREGULLSHMËRISË EKONOMIKE -
FINANCIARE DHE VLERËSUES",

Pasi u njohu me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e parashitë nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Bushetit Qendror Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mesipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

10:09 PM
11/11/2019

Plan i angazhimeve të NJAB për vitin 2018 - Microsoft Excel

Home Insert Page Layout Formulas Data Review View

Times New Roman 14 A A Word Tools General Conditional Formatting Styles Cell Styles Insert Delete Format Autosum Find & Select Editing

C3 = Plan i angazhimeve të NJAB për vitin 2018

1 NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MIBROJTJES SOCIALE

2

3 **Plan i angazhimeve të NJAB për vitin 2018** **Pasqyra 3**

4


Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fasha për tu audituar	Auditime Gjithëse (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulentëve	Grupi i Auditimit (nr.auditimes)
				A.M. Përkrahësitë	A.M. Performancës	Financiare	A.M. Informacionit	A.M. Inspeksionit		
1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5	
	Administrimi									
	Aparati Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Per fondet e BE-se	1	1						
	Shërbimi Parësor									
	Klinika Stomatologjike Universitare Tirane		1					1	1	
	Shërbimi Dytësor									
	Spitali Priëzorit Elbasan		1					1	1	
	Agjencia Kombetare e Barnave dhe									

Sheet1 Sheet2 Sheet3

Ready

10:11 PM 11.03.2018

7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Gjendet i publikuar informacioni në lidhje me raportet vjetore për zbatimin e buxhetit. Mungon informacioni për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara;**



7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme. **Informacioni i publikuar rezulton i pa përditësuar (Regjistri i Parashikimit të Prokurimit Publik viti 2018 dhe Regjistri i realizimit 8-mujor i Prokurimit Publik viti 2017);**

7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;**

Titulli	Niveli	Organizimi	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Buxheti	Niveli 1.a	Buxheti	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Informacion për procedurën e përbërjes	Niveli 1.a	Regjistrimi i Prokurimeve Publike	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Shërbimet e NISIN-it për publikun	Niveli 1.f	Sistemi i Dokumentit dhe Informacionit	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Parashtesa e dokumentit të përbërjes	Niveli 1.g	Parashtesa e dokumentit të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Shërbimet e dokumentit të përbërjes	Niveli 1.h	Shërbimet e dokumentit të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Regjistrimi i shërbimeve të përbërjes	Niveli 1.i	Regjistrimi i shërbimeve të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Informacioni dhe dokumenti të përbërjes	Niveli 1.j	Informacioni dhe dokumenti të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori

7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni nuk është i publikuar;**

7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit <http://shendetesia.gov.al/6-konsultime-mbi-projektligje/> por nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës, pasi linku i referuar nuk shfaq informacionin e kërkuar;**

Titulli	Niveli	Organizimi	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Buxheti	Niveli 1.a	Buxheti	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Informacion për procedurën e përbërjes	Niveli 1.a	Regjistrimi i Prokurimeve Publike	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Shërbimet e NISIN-it për publikun	Niveli 1.f	Sistemi i Dokumentit dhe Informacionit	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Parashtesa e dokumentit të përbërjes	Niveli 1.g	Parashtesa e dokumentit të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Shërbimet e dokumentit të përbërjes	Niveli 1.h	Shërbimet e dokumentit të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Regjistrimi i shërbimeve të përbërjes	Niveli 1.i	Regjistrimi i shërbimeve të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori
Informacioni dhe dokumenti të përbërjes	Niveli 1.j	Informacioni dhe dokumenti të përbërjes	Pastruesi	Ne faqen e tyre në internet	Drejtori

$f \in \mathcal{Q}_n$

Smoking Prevalence

Frank's Personality

Fin izveštis Nr. 2014-01-14 "Par notikimais, kurie konstatuoti patikrinant". Mindaugas Štandulavičius patvirtina projektą ir PRCP. DIRA PRITVIRTINANT NUDOMINUS NE LIEJUNINGA 2014 PRŪP RAIŠKĄ IR NUSPAUSD.

Keywords: self-esteem; social support; coping strategies

746 Značen je list iz 14.02.2014. Pri notnem dne konstituiranja pušča Ministrstvo a Slovenščine publikon projekcijen "PER DUBA PHTESA DNE NDRYSHINE NE UGON NR. 10107 DATE 30.03.2005 PER KUDESIN SHEFOTASQSTRE REPUBLICANF KNC DUBAF NDRYSHAR".

2009年10月27日 星期三


Faeti e interesuara mund te parashihet cdo dergimine rekomendimet e tyre me shkrim prane Menestres se Shkollestese. Adresa: Rruga e Kallabes nr 1000 Tirane cdo ne adresen e emailit: vojuna.2004@shkollestesa.al

- [illegible]

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni i publikuar rezulton i pa përditësuar (përditësimi i fundit në muajin tetor 2018);**

	A	B	C	D	E
75	73	16.05.2018	IDM	17.07.2018	Perfunduar pergjigja
76	74	28.05.2018	Emanuel Smaka	01.06.2018	Perfunduar pergjigja
77	75	04.06.2018	Adrian Baniusha	12.07.2018	Perfunduar pergjigja
78	76	05.07.2018	Edmond Hoxhaj	06.07.2018	Perfunduar pergjigja
79	77	09.07.2018	Edmond Hoxhaj	10.07.2018	Perfunduar pergjigja
80	78	19.06.2018	Kristofer Papa	27.06.2018	Perfunduar pergjigja
81	79	05.07.2018	Edmond Hoxhaj	11.07.2018	Perfunduar pergjigja
82	80	09.07.2018	Together for Life	16.07.2018	Perfunduar pergjigja
83	81	10.07.2018	Elisa Gjerani	11.07.2018	Perfunduar pergjigja
84	82	11.07.2018	Gjyste ÇUKA	11.07.2018	Perfunduar pergjigja
85	83	18.07.2018	Brejtton Xhavara	19.07.2018	Perfunduar pergjigja
86	84	18.07.2018	Denada Xhafaj	23.07.2018	Perfunduar pergjigja
87	85	23.08.2018	Edmond Hoxhaj	26.08.2018	Perfunduar pergjigja
88	87	02.10.2018	Gena Sollaku	02.10.2018	Perfunduar pergjigja

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;



7.1.l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. Informacioni është i publikuar;